



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Pranimi - Prilbena M. D. 21-03-2026			
Nr. Listimit Org. Eho.	Numeri	Vlera T	Vlera Vendnost
07-110/05-283			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d, neni 17 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/1008), kërkesa nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor Nr. 961-2/26 e datës 12.03.2026 dhe neni 36 shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë 01 Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 30.03.2026 miraton këtë:

## V E N D I M

**për shfuqizimin e Vendimit Nr. 01-110/05-277, të datës 02.03.2026 për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-0, me sipërfaqe 17758 m<sup>2</sup> në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla" e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e çerdhes dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja do të jete parcela Nr.1088-2, me sipërfaqe 4000 m<sup>2</sup>**

### Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendit i Komunës së Vitisë miraton vendimin për shfuqizimin e Vendimit Nr.01-110/05-277, të datës 02.03.2026 për ndërrimin e destinimit të parcelave të propozuara me Nr.1088-0, me sipërfaqe 17758 m<sup>2</sup> në pronësi juridike të "D.S Osnova Shkolla", e cila parcelë do të destinohet për ndërtimin e çerdhes dhe parcela në të cilën do të ndërtohet çerdhja do të jete parcela Nr.1088-2, me sipërfaqe 4000 m<sup>2</sup>.

### Neni 2

Shfuqizimi i vendimit bëhet me kërkesë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor Nr. 961-2/26 e datës 12.03.2026.

### Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Urbanizim, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi e Komunës së Vitisë.

### Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave Nr. 08/L-284, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.24/27 Dhjetor 2024), dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhën zyrtare në web faqe të Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorive përkatëse;
3. Shërbimit të Kuvendit; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I

Bekim Azizi